FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 63

Tiranë – E enjte, 9 prill 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 279, datë 7.4.2020	Për një shtesë në vendimin nr.926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", të ndryshuar.....	3529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 7.4.2020	Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit të Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar.....	3530
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 7.4.2020	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si shitës, dhe shoqërisë "LION CONSTRUCTION", sh.p.k., si blerës, për pasuritë shtetërore nr.6/76 dhe nr.6/187, në funksion të planeve të përgjithshme vendore.....	3533

VENDIM
Nr. 279, datë 7.4.2020

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.926, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET APO TRANSFORMOHET DHE PROCEDURËN E SHITJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 27, të kreut III, të vendimit nr.926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur për objektin që privatizohet ka një pronar apo disa bashkëpronarë, të cilët gëzojnë të drejtën e parablerjes dhe kanë shprehur interes për blerjen e objektit, duke bërë pagesën e vlerës së plotë të tij, janë të detyruar që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit me shkrim nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, të nënshkruajnë kontratën e shitjes për objektin me drejtorin e ndërmarrjes (apo përfaqësues të autorizuar të tyre dhe të organit që e ka në pronësi, ruajtje apo varësi administrative objektin) dhe drejtorin e strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë.

Njoftimi për të lidhur kontratën e shitjes me strukturën përgjegjëse për shitjen e pronës publike, në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, i bëhet secilit bashkëpronar që gëzon të drejtën e parablerjes, në bazë të një vendimi për njohje, kthim dhe kompensim prone, si dhe për faktin që secili prej tyre jo vetëm ka aplikuar për privatizimin e objektit, pronë shtetërore, që ndodhet mbi truallin e tyre por njëkohësisht ka përmbushur personalisht të gjitha detyrimet financiare, sipas legjislacionit në fuqi.

Në rast se një ose disa bashkëpronarë nuk paraqiten para zyrës noteriale për lidhjen e kontratës për pjesën takuese të dakordësuar, për të cilën kanë përmbushur rregullisht të gjitha detyrimet financiare, si dhe kanë marrë dijeni efektivisht, struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë u jep atyre një mundësi të dytë për t'u paraqitur, duke shtyrë në këtë mënyrë lidhjen e kontratës së shitjes për një datë tjetër.

Në rast se edhe pas njoftimit të dytë një ose disa bashkëpronarë, të cilët kanë përmbushur rregullisht të gjitha detyrimet financiare, nuk paraqiten pa ndonjë shkak të ligjshëm që të justifikojë mungesën e tyre, përveç rasteve të forcës madhore, struktura për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë u ofron bashkëpronarëve të tjerë, të cilët janë paraqitur, që të parapaguajnë për pjesën takuese të bashkëpronarëve në mungesë dhe lidh kontratën përfundimtare të shitjes vetëm me këta bashkëpronarë.

Shuma financiare, që bashkëpronari/ët në mungesë ka/kanë parapaguar dhe nuk është/janë paraqitur për sa më sipër, depozitohet në një llogari të posaçme në një nga bankat e nivelit të dytë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga lidhja e kontratës së shitjes, duke u njoftuar për këtë fakt nga struktura për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë.

Në rast se bashkëpronarët e paraqitur refuzojnë të paguajnë për blerjen e pjesës takuese të bashkëpronarëve në mungesë, kuota që këta bashkëpronarë refuzojnë të blejnë do të vazhdojë të ekzistojë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me bashkëpronar shtetin.

Në rast se të gjithë bashkëpronarët heqin dorë nga lidhja e kontratës së shitjes, pasi janë kryer të gjithë hapat e mësipërm proceduralë edhe pas njoftimit të dytë dhe nuk kanë paraqitur për këtë fakt asnjë shkak të ligjshëm që të justifikojë mungesën e tyre, struktura për shitjen e pronës publike në ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë anulon procedurat e shitjes së objektit

si dhe urdhëron kthimin e të gjitha pagesave financiare që ata kanë kryer.

Objekti i paprivatizuar do të vazhdojë të ngelet pronë shtetërore, duke pasur të drejtë shteti shqiptar ta administrojë me çdo formë të lejuar nga legjislacioni në fuqi, enfiteozë/lidhje kontratë qiraje me të tretët etj., investim për interes publik etj.).

Procedurat e privatizimit të objekteve apo të ndërmarrjeve, të realizuara nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe ish-Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, në ish-Ministrinë e Financave, me të drejtën e parablerjes për ish-pronarët e truallit, për të cilat janë kryer pagesat e plota për blerje, por që nuk janë përfunduar këto procedura (nënshkrimin e kontratave të shitjes dhe dorëzimi i pronës), do të përfundohen sipas procedurave të këtij vendimi.".

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 280, datë 7.4.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT TË PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE TË KONCESIONIT/PPP DHE KRITERET PËR VLERËSIMIN E KËRKESAVE TË AUTORITETEVE KONTRAKTUESE PËR MBËSHTETJE ME EKSPERTIZË TË SPECIALIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 12/1, të ligjit nr.125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit të Komitetit të Përzgjedhjes të Projekteve të Koncesionit/PPP dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave së autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE
PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT TË PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE TË KONCESIONIT/PPP DHE KRITERET PËR VLERËSIMIN E KËRKESAVE TË AUTORITETEVE KONTRAKTUESE PËR MBËSHTETJE ME EKSPERTIZË TË SPECIALIZUAR

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është mënyra e funksionimit të Komitetit të Përzgjedhjes të Projekteve të Koncesionit/PPP dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar.

Neni 2
Organizimi dhe funksionimi i Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP

1. Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP (në vijim Komiteti) është organ administrativ kolegjial, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka këta anëtarë:

a) Ministrin përgjegjës për financat;

b) Ministrin përgjegjës për infrastrukturën;

c)Ministrin përgjegjës për energjinë dhe industrinë;

ç) Ministrin përgjegjës për zhvillimin urban;

d) Ministrin përgjegjës për mjedisin.

2. Komiteti fton, rast pas rasti, pa të drejtë vote, titullarët e autoritetit kontraktues, të cilët kanë fushë të veprimtarisë objektin e projektit të koncesionit/PPP, për të argumentuar kërkesën e tyre. Nëse titullarët e autoritetit kontraktues janë njëherazi edhe anëtarë të Komitetit, nuk do të përjashtohen nga e drejta për të votuar.

Gjithashtu, Komiteti mund të ftojë në mbledhjen e tij edhe përfaqësues nga bota

akademike për të dhënë opinionin e tyre në lidhje me projektin e koncesionit/PPP.

Mosmarrja pjesë e palëve të interesuara ose e përfaqësuesve të tyre nuk pezullon a ndalon shqyrtimin e projektit.

3. Komiteti drejtohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, i cili kryen detyrat e mëposhtme:

a) Organizon dhe drejton punën e Komitetit;

b) Përcakton agjendën paraprake të mbledhjeve të Komitetit;

c) Përfaqëson Komitetin.

4. Datat e mbledhjeve të radhës vendosen nga kryetari dhe u bëhen të ditura anëtarëve të Komitetit, të paktën, 5 (pesë) ditë pune përpara datës së mbledhjes.

5. Mbledhjet e Komitetit janë të vlefshme kur janë pranishëm, të paktën, tre anëtarë me të drejtë vote. Anëtarët, në rast pamundësie pjesëmarrjeje në mbledhje, zëvendësohen nga zëvendësministri i caktuar prej tyre. Kur kjo shumicë nuk është mbledhur, caktohet një datë tjetër brenda 3 (tre) ditëve pune.

6. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

7. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Komitetit thirren nga kryetari.

8. Anëtarët e Komitetit njoftohen brenda 2 (dy) ditëve për çdo ndryshim të datës apo të orës së mbledhjes, si dhe për mbledhjet e jashtëzakonshme.

9. Komiteti vendos mbi bazën e dokumenteve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, me shumicën e të gjithë anëtarëve të pranishëm. Anëtarët e Komitetit nuk mund të abstenojnë. Në rast votash të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese.

10. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Votat e anëtarëve regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 3

Veprimtaria e Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP

1. Komiteti shqyrton dhe miraton me vendim kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar për:

a) hartimin e studimeve të fizibilitetit të projekteve të koncesionit/PPP;

b) kryerjen e oponencës së studimeve të fizibilitetit të projekteve të koncesionit/PPP;

c) kryerjen e oponencës së propozimeve të pakërkuara.

2. Komiteti mund të kërkojë mendimin e ekspertëve të fushës, në varësi të fushës të veprimtarisë së objektit të projektit të koncesionit/ PPP.

Neni 4

Sekretariati teknik i Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP

1. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) do të kryejë funksionet e Sekretariatit Teknik të Komitetit, duke kryer detyrat e mëposhtme:

a) Përgatit dhe i dërgon për shqyrtim rendin e ditës anëtarëve të Komitetit, brenda 5 (pesë) ditëve pune përpara datës së mbledhjes. Kërkesa për ta futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, nga anëtarët e Komitetit, të paktën 5 (pesë) ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen;

b) Shpërndan të gjitha materialet dhe dokumentet e nevojshme për vlerësimin e çështjeve të rendit të ditës anëtarëve të Komitetit, të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së mbledhjes. Në raste të veçanta, gjatë mbledhjes mund të shpërndahen materiale shtesë;

c) Merr masat organizative për përgatitjen e mbledhjeve të Komitetit;

ç) Kujdeset për përgatitjen e raportit dhe të materialeve të tjera, që duhet t'i paraqiten Komitetit për shqyrtim;

d) Bashkërendon punën e Komitetit me institucionet e tjera dhe palët e interesuara për çështjet e rendit të ditës së mbledhjes e për përgatitjen në kohë të materialeve;

dh) Mban procesverbalin e mbledhjes;

e) Mban dhe regjistron dokumentacionin e veprimtarisë së Komitetit;

ë) Lehtëson shkëmbimin e informacionit, ndërmjet palëve të interesuara apo personave të tjerë, rreth çështjeve të diskutuara nga Komiteti;

f) Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Komitetit;

g) Kryen procedurat e përzgjedhjes së konsulentëve të jashtëm, në përputhje me procedurat e prokurimit publik, pas marrjes së

vendimit të Komitetit për mbështetjen me ekspertizë të specializuar. Të gjitha shpenzimet administrative për kryerjen e këtyre procedurave mbulohen nga operatori i shpallur fitues nëse procedura rezulton e suksesshme.

Neni 5

Procedura e shqyrtimit dhe kriteret e vlerësimit të kërkesave për mbështetje me ekspertizë të specializuar

1. Autoritetet kontraktuese, nëse kanë nevojë për mbështetje me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimit të fizibilitetit, oponencën e studimit të fizibilitetit apo oponencë të propozimeve të pakërkuara, paraqesin kërkesë pranë Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO).

2. Në çdo rast, për projekte me vlerë mbi 100 000 000 (njëqind milionë) euro autoriteti kontraktues ka detyrimin të kërkojë mbështetje me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimit të fizibilitetit/oponencën e studimit të fizibilitetit/ oponencë të propozimeve të pakërkuara.

3. Kërkesa duhet të përmbajë argumente mbi përshtatshmërinë, nevojën dhe elemente të leverdishmërisë së dhënies së projektit të koncesionit/PPP, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 1 "Formati standard i kërkesës për mbështetje", bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

4. Afati për dorëzimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese, për mbështetje me ekspertizë të specializuar, me qëllim shqyrtimin dhe prioritarizimin e kërkesave është data 30 shtator i çdo viti buxhetor.

Përjashtimisht, për vitin 2020, kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar do të shqyrtohen rast pas rasti, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

5. Komiteti vlerëson kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje bazuar në kriteret e mëposhtme:

a) Vlerësimi për rëndësinë strategjike;

b) Vlerësimi i leverdisshmërisë dhe përballueshmërisë;

c. Vlerësimi mbi ndikimin social dhe mjedisor.

6. Vlerësimi i kërkesave bazuar në tri kriteret e pikës 5, të këtij neni, do të behet referuar tabelës së paraqitur në aneksin 2 "Tabela e pikëzimit", bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

7. Kërkesa dhe materialet e tjera, drejtuar Komitetit, dhe dokumentacioni përkatës, bashkëlidhur, paraqitet drejtpërdrejtë në Sekretariatin Teknik të Komitetit.

Aneksi 1 "Formati standard i kërkesës për mbështetje"

Hyrje

Përshkrimi i shkurtër i projektit dhe qëllimet kryesore.

Pikënisja e projektit

Procesi i planifikimit kombëtar, rajonal/lokal apo në nivel sektori; analiza e gjendjes infrastrukturore, identifikimi i mungesave të shërbimeve dhe/ose nevojave të investimit; ose projekt ide të nxitura nga prioritetet e politikave.

Situata Aktuale

Në përshkrimin e situatës aktuale studimi i fizibilitetit mund ti referohet pikave aktuale duke i përdorur sipas llojit dhe natyrës së projektit.

Përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore apo të hapësirave të zhvillimit, kontekstin e përmirësimit dhe, nëse është e përshtatshme, një pasqyrë të tregut;

Projekti Teknik

Analiza teknike duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

Sfondin e projektit.

Vendndodhjen dhe truallin.

Përshkrimin konstruktiv, funksional dhe teknik të projektit.

Periudha e vlerësuar e ndërtimit

Periudha e parashikuar e operimit

Ndikimet mjedisore dhe sociale

Efektet e mundshme negative apo të kundërta në përbërësit mjedisorë por që nuk kufizohen vetëm te: popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, aspekte të biodiversitetit, duke përfshirë speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe identifikimin e atyre që mbrohen ligjërisht. Ai duhet të tregojë, gjithashtu, edhe aspektet sociale, çështjet e punësimit etj.

Të dhëna ekonomike dhe financiare

- Investimet e parashikuara
- Kostot indirekte të projektit
- Burimi i të ardhurave të projektit dhe parashikimi i tyre për gjithë kohëzgjatjen e kontratës

- Analizë paraprake risku në mënyrë që të identifikohet dhe të vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin.
- Mundësitë buxhetore të projektit sipas viteve

Referenca për ekspertizën e kërkuar

Specifikimet teknike

Aneksi 2 "Tabela e pikëzimit"

Nr.	Kriteri	Pikët maksimale	Vlerësimi me pikë i projektit
1.	Vlerësimi për rëndësinë strategjike	40	
2.	Vlerësimi i leverdishmërisë dhe përballueshmërisë	40	
3.	Vlerësimi mbi ndikimin social dhe mjedisor	20	
	Total	100	

VENDIM
Nr. 281, datë 7.4.2020

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS PËR KALIMIN E PRONËS SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI SHITËS, DHE SHOQËRISË "LION CONSTRUCTION", SH.P.K., SI BLERËS, PËR PASURITË SHTETËRORE NR.6/76 DHE NR.6/187, NË FUNKSION TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim, të vendimit nr.807, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si shitës, dhe shoqërisë "LION CONSTRUCTION", sh.p.k., si blerës, për pasuritë shtetërore nr.6/76, me sipërfaqe 205 m2, dhe nr.6/187, me sipërfaqe 85 m2, në funksion të planeve të përgjithshme vendore, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama


GENPLAN I PRONAVE, TIRANE
6/452
6/170
6/77
6/451
6/187
6/76
6/130
6/167
6/89
6/91
6/189
SIPERFAQET
6/130 SIPERFAQJA S=480m²
6/76 SIPERF
6/451 SIPERFAQJA S=2170m²
6/187 SIPER

Shkalla 1:500



KUFITARET
VERI 6/452
JUG 6/167,6/188
LINDJE 6/77,6/170
PERENDIM RRUGE

LEGJENDA
— KUFIRI I PRONES
PRONA SHTET
PRONA PRIVATE

AQJA S=224−19=205m²

FAQJA S=114−29=85m²

KONFIRMOI

PERFAQESUESI I PREFEKTIT QARKUT TIRANE:

Alfred Skapi

PERFAQESUESI I ASHK DREJTORIA VENDORE TIRANE:

Naime Zogoroni

PERFAQESUESI I MFE DREJTORI I DREJTORISE PRONAVE PUBLIKE:

Idliv Xhoxhi

BLERESI:

Klement Agollia

LION CONSTRUCTION L62309009J

Ing.Margarit STAVRI

Lic N.1188/1 Date 29.05.2017

MARGARIT STAVRI Ing.Gjeodet Licence Nr. T1188/1

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë